



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2  
Dhjetor 2024

## **ROLI I PRESIDENTIT NË BALANSIMIN DHE KONTROLLIN KUSHTETUES TË TRE PUSHTETEVE: ANALIZË KUSHTETUESE DHE KRAHASIMORE**

**Arsim Bajrami\*, Visar Morina\*\***

*\*Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës*

*\*\*Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës*

### **Përmbledhje**

Një ndër tiparet themelore të sistemeve parlamentare të qeverisjes është pozita e veçantë kushtetuese e kreut të shtetit në balansimin e pushteteve. Në shumë demokraci parlamentare, presidenti mbart një rol simbolik dhe përfaqësues, por edhe një detyrë thelbësore në ruajtjen e stabilitetit dhe funksionimit të institucioneve kushtetuese. Neni 4 i Kushtetutës së Kosovës materializon parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve duke i akorduar Presidentit të Republikës një pushtet neutral me kompetenca tipike të garantimit të funksionimit kushtetues të organeve kushtetuese. Por ushtrimi I kompetencave presidenciale në sisteme të përzgjedhura parlamentare ka ngritur jo rrallë dilemën se cilën janë kufijtë kushtetues të “pushtetit neutral” të presidentit në procesin e arbitrimin të konflikteve kushtetuese në mes tre degëve të pushtetit shtetëror.

Ky punim analizon aspektin teorik dhe jurisprudencial të rolit të presidentit si balancues i pushteteve kushtetuese në rajon dhe me gjerë. Përmes vlerësimit interpretativ të kushtetutave të përzgjedhura për këtë qëllim, ky punim analizon kompetencat specifike presidenciale që burojnë nga kushtetutat nacionale në procesin e arbitrimin kushtetues të tre degëve të pushtetit shtetëror. Për më tepër, ky kontribut mbështetet edhe në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese, në vendimet e së cilave është ravigjzuar edhe më qartë koncepti Shmittian i pushtetit neutral të presidentit në garantimin e funksionimit kushtetues të degëve të pushtetit shtetëror dhe në identifikimin e mënyrave përmes të cilave presidenti mund të veprojë si një balancues efektiv i pushteteve në interesin e stabilitetit dhe funksionimit të demokracisë.

**Fjalë çelës:** *Sistemet parlamentare, kreu i shtetit, ndarja e pushteteve, presidenti, pushteti neutral, institucionet kushtetuese, Kushtetuta e Kosovës, Konfliktet kushtetuese, Degët e pushtetit shtetëror, arbitrazhi kushtetues, analiza teorike, aspekti jurisprudencial, koncepti Schmittian, Gjykatat kushtetuese, pushtetet balancuese, Demokracia, Funksionimi kushtetues, vlerësimi interpretues, Kompetencat presidenciale.*

# THE ROLE OF THE PRESIDENT IN THE CONSTITUTIONAL BALANCING AND CONTROL OF THE THREE POWERS: CONSTITUTIONAL AND COMPARATIVE

## Abstract

One of the basic features of parliamentary systems of government is the special constitutional position of the head of state in the balance of powers. In many parliamentary democracies, the president carries a symbolic and representative role, but also an essential task in maintaining the stability and functioning of constitutional institutions. Article 4 of the Constitution of Kosovo materializes the constitutional principle of the separation of powers by granting the President of the Republic a neutral power with typical powers of guaranteeing the constitutional functioning of the constitutional bodies. But the exercise of presidential powers in selected parliamentary systems has often raised the dilemma of what are the constitutional limits of the “neutral power” of the president in the process of arbitrating constitutional conflicts between the three branches of state power. This paper analyzes the theoretical and jurisprudential aspect of the role of the president as a balancer of constitutional powers in the region and beyond. Through the interpretative evaluation of the constitutions selected for this purpose, this paper analyzes the specific presidential powers that originate from the national constitutions in the process of constitutional arbitration of the three branches of state power.

This paper analyzes the theoretical and jurisprudential aspect of the role of the president as a balancer of constitutional powers in the region and beyond. Through the interpretative evaluation of the constitutions selected for this purpose, this paper analyzes the specific presidential powers that originate from the national constitutions in the process of constitutional arbitration of the three branches of state power. Moreover, this contribution is also based on the jurisprudence of the constitutional courts, in whose decisions the Schmittian concept of the neutral power of the president in guaranteeing the constitutional functioning of the branches of state power and in identifying the ways through which the president can act as an effective balancer of powers in the interest of the stability and functioning of democracy.

**Keywords:** *Parliamentary systems, Head of state, separation of powers, President, neutral power, constitutional institutions, Kosovo Constitution, Constitutional conflicts, Branches of state power, Constitutional arbitration, theoretical analysis, Jurisprudential aspect, Schmittian concept, Constitutional courts, balancing powers, Democracy, Constitutional functioning, interpretative evaluation, Presidential powers.*

## I. Roli i presidentit ne sigurimin e balansit kushtetues te tre pushteteve.

Presidentit si kreu i shtetit dhe si përfaqësues i unitetit të popullit. Atributi i presidentit si kreu i shtetit, është një atribut që edhe kushtetutat e vendeve të tjera ia veshin presidentit, duke nënkuptuar se ai (presidenti) është figura më e lartë dhe kryesore në një shtet. Atributi tjetër kushtetues se presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit i ka rrënjët qysh në debatin e largët në mes të Schmitt dhe Kelzen.

Megjithatë edhe në aspektin kushtetues por edhe në aspektin e normës “uniteti i popullit” dhe përfaqësimi i tij nga ana e presidentit është më shumë një nocion filozofik sesa kushtetues. Ky atribut kushtetues për më tepër i takon presidentit edhe për faktin se presidenti është një i vetëm si dhe kryen funksione te veçanta kushtetuese<sup>1</sup>. Por në fakt cilat janë disa nga kushtet që presidenti duhet

1 Florent Muçaj, “Pozicioni kushtetues i presidentit karshi unitetit të popullit-shqyrtime anal-

të plotësojë që të jetë një përfaqësues i unitetit të popullit. Ndër kushtet e para dhe më kryesore, që njëherësh është edhe argumenti kryesor kushtetues ka të bëjë me të qenit jo partiak apo jo politik të presidentit. Pra, siç u tha, uniteti i popullit si koncept ka lindur gjatë debatit në mes të C.Schmitt dhe H.Kelzen, në vitet e 30-ta të shekullit të kaluar kur zhvillohej në lidhje me pozitën e shefit të shtetit (presidentit) në kuadër të kushtetutës së Vajmarit<sup>2</sup>.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 83 përcakton se presidenti është kreu i shtetit si dhe përfaqësues i unitetit të popullit. Shumë kushtetuta të vendeve demokratike i kanë dhënë presidentit atributin e të qenit përfaqësues i unitetit të popullit dhe kombit<sup>3</sup>, duke i dhënë atij (presidentit) një mundësi që të qeverisë me vendin më mënyrë neutrale. Pra uniteti i popullit është atribut themelor i presidentit, që lidhet me funksionet e veçanta që duhet të kryej presidenti në një sistem kushtetues. Presidenti është kreu i shtetit i cili duhet të jetë një aktor aktiv i qeverisjes, por mbi të gjitha duhet të jetë jo politik apo të mos ketë funksion në ndonjë parti politike, të jetë neutral, objektiv në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese si dhe vendimet e tij të jenë të atilla që reflektojnë qartësi dhe objektivitet në syrin e qytetarëve. Pra uniteti i popullit si një atribut i rëndësishëm kushtetues i presidentit duhet të kuptohet në atë mënyrë që roli kryesor i presidentit në një sistem kushtetues është që ai të ushtrrojë unitetin e popullit, dhe këtë ai mund ta arrijë përmes vendimeve dhe veprimeve të tij që reflektojnë neutralitet, integritet dhe objektivitet dhe atë: përmes vendimeve të mira dhe në të mirë të qytetarëve; përmes neutralitetit ndaj politikës dhe partive politike; përmes rolit të tij në zgjidhjen e krizave politike apo përmes ushtrimit të kompetencave të tij në atë mënyrë që sigurojnë funksionimin normal të sistemit kushtetues, si dhe reflektojnë besueshmëri tek qytetarët<sup>4</sup>.

Ish presidenti i Republikës së Shqipërisë z.Alfred Moisiu, në një kumtesë të tij të në konferencën “Roli i presidentit në përcaktimin e modelit të qeverisjes në Republikës”, mbajtur në Prishtinë me 28 shkurt 2012, unitetin e popullit si atribut i presidentit e cilëson si diçka të lidhur ngushtë me figurën e presidentit dhe me të gjitha kompetencat e tij<sup>5</sup>. Uniteti i popullit tek presidenti, përveç të tjerash mund të përfaqësohet përmes ushtrimit të kompetencave që kushtetuta i përcakton për presidentin.

Siç e thamë, njëjtë sikur në dispozitat konkrete të kushtetutave të lartpërmendura, kushtetuta e Kosovës i referohet unitetit të popullit si atribut në nenin 83 të saj duke mos dhënë sqarime të mëtutjeshme, se si mund të përfaqësojë presidenti unitetin e popullit. Në kuptim të interpretimit të kushtetutës së Kosovës uniteti i popullit si atribut i veçantë i presidentit si kreu i shtetit është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në disa raste.

---

itike”, revista studime shoqërore, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2014, fq.221-249.

2 Shih me tëpër për këtë debat: Luis Pereira Coutinho, Massimo La Torre, Steven D.Smith; *Judicial Activism – “An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences; Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice”*; Springer International Publishing; Switzerland; 2014; fq.89 ose Stockholm Institute for Scandianvian Law; Stanley L. Paulson; *Some Issues in the Exchange between Hans Kelsen and Erich Kaufmann*; 2010; fq.2.

3 Këtu vlenë të përmenden për shembull: Kushtetuta e Bullgarisë, neni 92.1.; Kushtetuta e Francës neni 5.; Kushtetuta e Republikës së Greqisë, neni 30.1; Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane - 1949, neni 56; Kushtetuta e Hungarisë, seksioni 29.1; Kushtetuta e Italisë, 1948, neni 87; Kushtetuta e Mbretërisë së Spanjës, neni 56 (Kurora); Kushtetuta e Rumanisë, neni 80.1; Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, neni 94; Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, neni 102; Kushtetuta e Federatës Ruse, neni 80.2; Kushtetuta e Republikës së Turqisë, neni 40 etj.

4 Florent Muçaj, “Pozicioni kushtetues i presidentit karshi unitetit të popullit -shqyrtime analitike”, revista studime shoqërore, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2014, fq.221-249.

5 Fjala e ish-Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu në konferencën “Roli i presidentit në përcaktimin e modelit të qeverisjes në Republikë”, Prishtinë, 28.02.2012, ku ndër të tjera thotë: “...duhet të kuptojmë çdo gjë që cenon jo vetëm tërësinë territoriale të vendit, por të gjitha problemet që cenojnë unitetin e popullit dhe shqetësimet që çojnë në krijimin e problemeve që mund të krijojnë situata destabilizuese...”.

Në rastin nr. KI47/10 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, uniteti i popullit trajtohet në prizmin e asaj që një president nuk mund të mbajë funksione në parti politike. Mbjatja e postit në një parti politike, sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e “lëndon” unitetin e popullit, pasi që të qenit pjesë e një partie politike presidentin do ta vendoste në një pozicion të njëanshëm kushtetues përballë unitetit të popullit në përgjithësi dhe unitetit politik në veçanti. Ndër të tjera, në lidhje me unitetin e popullit Gjykata Kushtetuese e Kosovës në rastin nr. KI47/10 konstaton: “*Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna në bazë të Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të presupozojë se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo një fragment ose interes politik partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit. Kjo për më tepër, kur ai ushtron zgjedhje politike, si kur zgjedh kandidat konkurrent nga koalicionet e mundshme për t’u zgjedhur Kryeministër*”<sup>6</sup>. Në bazë të këtij rasti, një ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësojë presidenti për të qenë përfaqësues i unitetit të popullit është që të mos mbajë ndonjë pozitë në parti politike, qoftë edhe pozitën e anëtarit të thjeshtë. Ky është një standard kushtetues tanimë i zbatueshëm në Republikën e Kosovës<sup>7</sup>.

Lidhur me përfaqësimin e unitetit të popullit, i njëjti standard duhet të zbatohet edhe tek presidenti i cili zgjedhet nga populli. Pra në asnjë mënyrë presidenti i zgjedhur nga populli nuk duhet të reflektojë njëanshmëri politike, madje kjo vlen edhe në rastet kur një president i zgjedhur nga populli kërkon mbështetjen e partisë politike për tu zgjedhur me votë popullore. Këtë standard Gjykata Kushtetuese e Kosovës e kishte ngritur në rastet KO29/12 dhe KO48/12<sup>8</sup>. Përveç këtyre që u thanë nënkuptohet që unitetit i popullit dhe përfaqësimi i tij nga ana e presidentit buron nga vetë zgjedhja e tij (presidentit), qoftë nga populli apo nga parlamenti (nga zgjedhësit e popullit) si dhe lidhet me mandatin e presidentit, gjatë të cilit populli ka pritshmëri nga presidenti i tyre që të përfaqësojë unitetin e popullit, duke mbrojtur interesat kushtetuese të shtetit. Në kontekstin e mandatit të presidentit dhe mënyrës së zgjedhjes së tij, po në rastet KO29/12 dhe KO48/12, shtrohet ky dimension i përfaqësimit të unitetit të popullit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ku ndër të tjera përcaktohet: “*Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme. Kështu që, shkurtimi i mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin 10, e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin*”<sup>9</sup>.

Pra përfaqësimi i unitetit të popullit është një atribut kushtetues dhe një e drejtë legjitime që buron nga populli dhe kushtetuta, dhe që i takon vetëm presidentit si institucion kushtetues (kreu i shtetit, i pari i shtetit) që kryen funksione të veçanta.

Ndryshimi i kushtetutës në pjesën që ka të bëjë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë paraqet një ndryshim substancial të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës. Ky ndryshim prek në bazat e sistemit të qeverisjes duke quar Kosovën drejt një sistemi gjysmë-presidencial me një rol proaktiv të presidentit dhe me sigurimin e elementeve dominuese të demokracisë parlamentare, që i mundësojnë

6 Aktgjykim Rasti nr. KI47/10, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, paragrafi 69.

7 Ibid, paragrafi 66, “Nëse një parti politike ka miratimin nga Presidenti i Republikës, ka një aset të madh politik për të avancuar agjendën e tij politike dhe zgjedhjen e kandidatëve të tij për detyrë zyrtare publike”.

8 Këtu ndër të tjera në paragrafin 140 theksohet: “Gjykata më tej vëren që neni 88 [Papa-jtueshmëria] i Kushtetutës, sa i përket formës aktuale dhe asaj që propozohet në amendament i nenit 88, ndalon ushtrimin e çdo funksioni në parti politike. Baraspesha që duhet të arrihet nga cilido President i ardhshëm në detyrë që ushtron postin e Presidentit dhe kërkon mbështetjen e partisë politike duhet të kihet parasysh nëse ai President në detyrë dëshiron të rizgjedhet. Vështirësia e gjetjes së rrugës e cila siguron që neni 88 nuk cenohet, në ndërkohë që ka edhe angazhim në procesin politik të Presidentit në detyrë, kërkon shqyrtim dhe trajtim të kujdesshëm”.

9 Rastet KO29/12 dhe KO48/12 -Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012, paragrafi 255.

mazhorancës politike krijimin e qeverisë dhe drejtimin politik të vendit. Edhe kushtetuta e tanishme për nga koncepti dhe kompetenca e organeve ka siguruar një rol aktiv të presidentit në shumë sfera që janë tipike për sistemet gjysëmpresidenciale. Së këndejmi kjo reformë ka logjikë të plotë kushtetuese-juridike dhe do të ndikojë në shmangien e krizave dhe sigurimin e stabilitetit politik dhe kushtetues të vendit. Janë disatribute thelbësore të konceptit të presidentit popullor,

1. **Legjitimiteti demokratik** që derivon nga zgjedhja e drejtpërdrejt nga populli, e jo nga marrëveshjet politike parlamentare;

2. **Besueshmëria e presidentit** si rezultat i besimit që i jep populli me zgjedhje të drejtpërdrejt, ku ai merr besim të një numër shumë të madh të votuesve në raport me votat e marra në parlament;

3. **Kredibiliteti institucional** i presidenti buron nga kushtetuta dhe autoriteti kushtetues, përmes kompetencave të gjëra kushtetuese që nga ato ceremoniale e përfaqësuese, ekzekutive, kontrollues e deri të autorizimet supreme në sektorët e sigurisë;

4. **Neutraliteti i presidentit** si rrjedhojë e shmangies së çfarëdo konflikti partiak apo konflikti tjetër të interesit. Një president apartiak ka një rol neutral në jetën politike dhe ai përfaqëson unitetin e popullit dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës;

5. **Roli unifikues i presidentit** vjen në shprehje në unifikimin e interesave qytetare dhe kombëtare të popullit të Kosovës dhe të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës. Presidenti promovon, përfaqëson dhe mbron interesat kombëtare dhe shtetërore të Republikës së

Kosovës brenda dhe jashtë;

6. **Roli koheziv i presidentit** vjen në shprehje në lidhshimin e tij, për të stimuluar dialogun politik dhe ndëretnik me qëllim të kohezionit qytetar dhe kombëtarë në vend;

7. **Sigurimi i funksionimit demokratik** të institucioneve është përgjegjësi e Presidenti, i cili kujdeset që institucionet e pushtetit të funksionojnë brenda limiteve dhe linjave të përcaktuara kushtetuese;

8. **Roli mbikëqyrës i presidentit** në çështjet shtetërore dhe kombëtare i Presidentit vjen në shprehje në kontrollin e legjislacionit përmes të drejtës së vetos dhe rishikimeve të emërimeve të larta në gjyqësore, politikë të jashtëm sektorin e sigurisë dhe në agjencitë e pavarura,

9. **Zgjidhja e krizave kushtetuese** bazohet në autoritetin e presidentit në shpërndarjen e parlamentit, në rastet e përcaktuara me Kushtetutë, shpalljen e zgjedhjeve parlamentare dhe referimin e çështjeve të caktuara të Gjykata Kushtetuese,

10. **Roli tranzicional i presidentit** konsiston në rolin e tij në proceset e alternimit parlamentar dhe tranzicionit të pushtetit prej një qeverie në tjetrën duke mundësuar një proces paqësor dhe demokratik.

Duke siguruar këtotribute kushtetuese ndryshimet kushtetuese do të sigurojnë presidentit kredibilitetin e nevojshëm politik dhe demokratik, që ai të ndërtoj lidhshimin e tij si kreu i vendit. Ky element do të shmangte krizat politike që janë tipike për president parlamentar. Kosova ka qenë shembull tipik i këtyre krizave për faktin se për një periudhë të shkurtë janë larguar dy ish president si pasojë e shkeljeve kushtetuese. Kriza të këtilla shmangen tek presidentët e zgjedhur drejtpërdrejt sepse nuk lidhen me procedurat e formimit të qeverisë dhe ndërtimit të koalicioneve politike. Tani presidenti merr rolin e tranzicionit në proceset e alternimeve parlamentare duke mundësuar kontinuitetin kushtetues të vendit.

## II. Çështje të përzgjedhura nga praktika e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

### A. Çështja e ish-Presidentit Sejdiu (Aktgjykimi në rastin KI 47/10)<sup>10</sup>

Lidhur me konstatimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sa i përket Aktgjykimit të shtatorit të vitit 2010 për antikushtetutshmërinë lidhur me mbajtjen e pozitës së Kryetarit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nga Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, relevante për vendimin janë çështjet si më poshtë:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka elaboruar qëndrimin për pranimin e Kërkesës dhe konstatimit sipas pretendimit të parashtruesve se Presidenti Sejdiu ka vepruar në kundërshtim me nenin 88 [Papajtueshmëria], paragrafi 2, të Kushtetutës së vendit kur ka vendosur mbajtjen e pozitës së Kryetarit të subjektit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe pas zgjedhjes së tij si President i Republikës së Kosovës<sup>11</sup>.

Çështje kontestuese e rastit është shkresa e 3 deputetëve që dërgojnë njoftim për të revokuar nënshkrimin e tyre për parashtrim të kërkesës në Gjykatë e ku paraqitet edhe hapësira e revokimit për deputetin Numan Baliq por i cili nuk e nënshkruan të njëjtën. Gjykata e sqaron se sipas nenit 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, çështja që parashtrohet fillimisht sipas procedurës ligjore dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese, do të vazhdohet trajtimi në merita të rastit<sup>12</sup>.

Andaj, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit fillestar të bazueshmërisë së lëndës dhe vlerësimit se janë përmbushur paraprakisht kushtet për referim të çështjes sipas nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendos për meritat e lëndës, duke u thirrur në veprim në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren si dhe praktikën e saj të punës, në mënyrë që të shmanget çfarëdo mundësie e ndikimit potencial në deputetët që kanë ndryshuar mendim pasi fillimisht e dërgojnë kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Përtej aspektit procedural, Gjykata Kushtetuese argumenton elementin e shkeljes kushtetuese, me ç'rast Presidenti Fatmir Sejdiu, në shpërputhje me nenin 88 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbi bazën e mbajtjes dhe ushtrimit në mënyrë të vazhdueshme (anipse Presidenti Sejdiu kishte dërguar letër njoftuese zyrtare për “ngrirjen e postit”) të pozitës së Kryetarit të subjektit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Bazuar në këto fakte të sipërcekura si dhe sipas mënyrës së interpretimit kushtetues nga Gjykata e Republikës së Kosovës, vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese ishte në favor të gjetjes kundërkushtetuese si shkelje serioze<sup>13</sup> nga Presidenti z. Fatmir Sejdiu në mbajtjen e pozitës së kreut të subjektit politik në kohën sa ka qenë i zgjedhur si President të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, dy gjyqtarë, Almiro Rodriguez dhe Snezhana Botusharova ndajnë veçmas bindjen personale mbi këtë rast, duke lëshuar mendim mospajtues<sup>14</sup> me Aktgjykimin e shtatorit të vitit 2010 për antikushtetutshmërinë e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu.

Dy gjyqtarët mospajtues, përmendin dhe argumentojnë raste të ndryshme nga praktika gjermane (siç

10 Autorët në mënyrë të veçantë falënderojnë z. Bajrush Rrahmani, kandidat për master në të drejtën kushtetuese për kontributin në hulumtimin e praktikës relevante kushtetuese lidhur me këtë analizë.

11 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI 47/10 - [https://gjk-ks.org/epcontent/uploads/vendimet/ki\\_47\\_10\\_shq\\_2.pdf](https://gjk-ks.org/epcontent/uploads/vendimet/ki_47_10_shq_2.pdf)

12 Lexo paragrafin 39 të Aktgjykimit KI 47/10

13 Pika II e Aktgjykimit KI 47/10

14 Lexo mendimin mospajtues të gjyqtarëve Almiro Rodriguez dhe Snezhana Botusharova - [https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2017/11/Mendimet-Mospajtuese-2009-2010\\_SHQIP.pdf](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2017/11/Mendimet-Mospajtuese-2009-2010_SHQIP.pdf) fq. 36

është rasti me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë në rastin e Organstreit<sup>15</sup> të datës 30 qershor 2009, paragrafi 169), duke e shtruar për diskutim çështjen e autorizimit ligjor të deputetëve parashtrues, faktin se nuk kanë pasur përfaqësues të tyre<sup>16</sup> dhe sidomos sagën e tërheqjes së nënshkrimeve që përfundon me vetëm 26 nënshkrues të Kërkesës, për të cilën pretendojnë se duhet ta ketë të paktën numrin minimal të kërkuar ligjërisht gjatë gjithë procedurës për ruajtje të stabilitetit ligjor. Kësisoj, ata në thelb e konsiderojnë Kërkesën të papranueshme.

Në të njëjtën mënyrë argumentojnë edhe në rastin e vlerësimit të afatit kohor të parashtrimit të Kërkesës e cila sipas tyre qartazi nuk është paraqitur sipas nenit 45 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese<sup>17</sup>, dispozitë e cila saktëson dhe kufizon të drejtën e referimit të çështjes së shkeljes së supozuar nga Presidenti i vendit në afat prej 30 ditësh nga publikimi i shkeljes. Në argumentim të zbatimit rigoroz ligjor të afateve, të njëjtit citojnë rregullën “6-mujore” – kriteri *ratio legis* të parashtrimit të rasteve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, afat i cili nëse nuk respektohet, vendimi nuk mund të kontestohet më tej<sup>18</sup>.

Nacionin e shkeljes së vazhdueshme të pranuar nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët mospajtuës e kundërgumentojnë me historinë e gjatë ligjore në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që nga rasti fillestar i De Becker (1958), duke kaluar në Loizidou v. Turkey (1996), Cyprus v. Turkey (2001) dhe Ilascu and Others v. Moldova and Russia (2004), deri në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në Varnava v. Turkey (2009)<sup>19</sup>.

#### **B. Çështja kushtetuese në rastin e ish-Presidentit Pacolli (Aktgjykimit nr. KO 29/11 për vlerësimin e kushtetutshmërisë të procedurës së zgjedhjes së Presidentit)**

Përkitazi me Aktgjykimin KO 29/11 si dhe mendimin mospajtuës të dy gjyqtarëve me këtë Aktgjykim, ka një mori elementesh të rëndësishme për t’i analizuar në raport edhe me ndikimin në jetën institucionale dhe politike të shoqërisë kosovare, sidomos duke marrë parasysh faktin se në momentin e nxjerrjes së Aktgjykimit mbi këtë rast, Republika e Kosovës ka qenë vetëm në vitin e tretë pas shpalljes si shtet i pavarur dhe sovran.

Mendimi i shumicës së gjyqtarëve është i bazuar në interpretimin e mënyrës se si është i formuluar neni 86 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku parashihen kushtet dhe kufizimet që duhen respektuar në procedurën për zgjedhjen e Presidentit në Republikën e Kosovës<sup>20</sup>.

Në anën tjetër, interpretimi i dy gjyqtarëve që e kanë hartuar mendimin mospajtuës me Aktgjykimin KO 29/11, janë fokusuar në përmbajtje më të gjerë duke u lëshuar në interpretime në aspektin terminologjik dhe atë lingvistik, duke evidentuar edhe mungesa të parashikueshmërisë juridike, të cilat mund të krijojnë edhe situata të komplikuar e të dëmshme për jetën institucionale, posaçërisht në situata të tilla konkrete me rëndësi imperative siç është rasti me zgjedhjen e kreut të shtetit<sup>21</sup>.

Relevancë që meriton vëmendje në arsyetim të mendimit të tyre është analogjia e dy gjyqtarëve mospajtuës me zgjedhjen e Presidentit Ibrahim Rugova sipas Kornizës Kushtetuese në vitin 2002 (si kandidat i vetëm)<sup>22</sup> dhe më 2004 ku kishte pasur 2 kandidatë (Ibrahim Rugova dhe Ramë Buja). Por,

15 Po aty, fq. 37

16 Lexo paragrafin 5 të mendimit mospajtuës me Aktgjykimin KI 47/10

17 Lexo nenin 45 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

18 Finucane v. The United Kingdom, (dec.) No.29178/95, 2 korrik 2002; Xv. France, No. 9587/82, Vendimi i Komisionit me 13 dhjetor 1982, Vendime dhe Raporte (DR) 29, p.235.

19 Paragrafi 22 i mendimit mospajtuës të gjyqtarëve Almiro Rodriguez dhe Snezhana Botusharova në lëndën nr. KI 47/10

20 Lexo në tërësi nenin 86 [Zgjedhja e presidentit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

21 Mendimi mospajtuës i gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues - [https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjkk\\_ko\\_29\\_11\\_mm\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_29_11_mm_shq.pdf)

22 Lexo mendimin mospajtuës të dy gjyqtarëve në rastin KO 29/11, faqe 3

në vitin 2006, pas ndërrimit jetë të Presidentit Ibrahim Rugova, sipas po të njëjtës Kornizë kishte qenë kandidat vetëm Fatmir Sejdiu, ndërkaq 2 vjet më vonë, përsëri mbështetur në Kornizën Kushtetuese, në procesin e votimit për President kishin qenë 2 kandidatë (Fatmir Sejdiu dhe Naim Maloku).

Në mendimin mospajtues të dy gjyqtarëve, rëndësi të lartë i kushtohet faktit të nxjerrjes në dritë dalimit midis kuorumit<sup>23</sup> dhe votimit (që dallon në raste të ndryshme - varësisht prej natyrës së votimit), mirëpo kuorumi është gjithnjë i njëjti - më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit - përkatësisht të paktën 61 deputetë – 50+1%.

Ndërkaq, sa i përket çështjes së numrit të kandidatëve, duhet theksuar se Kushtetuta e Kosovës në paragrafin 5 edhe në paragrafin 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] i referohet kontekstit të më shumë se një (1) kandidati (megjithëse nuk e ndalon shprehimisht vetëm një të tillë)<sup>24</sup>.

Në faqe 4 të mendimit të tyre mospajtues, dy gjyqtarët shprehin: “Hartuesit e Kushtetutës nuk mund të kenë menduar një përfundim të tillë jologjik. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për t’i urdhëruar Kuvendit që të nominojë më tepër se një kandidat”<sup>25</sup>.

Mirëpo, vlerësojmë se sipas kompetencave kushtetuese dhe ligjore që i atribuohen, është detyrë kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese si instancë përfundimtare ta interpretojë Kushtetutën. Pra, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese përtej asaj pse të mendojnë se si mund të ketë menduar hartuesi i Kushtetutës, e interpretojnë atë sipas asaj që hartuesi e ka formuluar dhe e ka shprehur tekstualisht në akt.

Përfundimisht, në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO 29/11 Gjykata është shprehur se lidhur me numrin e votave që kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86-4 i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat e “votave të të gjithë deputetëve” të Kuvendit, që do të thote se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose me shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë.

### C. Çështja KO 72/20 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020

Aktgjykimi KO 72/20 i Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë epilog një nga ‘dramave’ më interesante politiko-institucionale të Republikës së Kosovës që nga koha e shpalljes së Pavarësisë.

Në këtë rast, objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar të Presidentit të Republikës së Kosovës, për të cilin parashtuesit e kërkesës – deputetët e subjektit politik “Lëvizja VETËVENDOSJE!” kanë pretenduar se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>26</sup>.

Gjykata Kushtetuese në një Aktgjykim jashtëzakonisht të gjatë për këtë rast, ka dhënë shpjegime tejet të zgjeruara për shumë nga konceptet e autorizimeve publike që përmbajnë personat fizik apo juridik, detyrat dhe përgjegjësitë që ngërthen pozicioni i subjektit apo koalicionit fitues politik në një cikël zgjedhor, si dhe elaborime procedurale të tjera me rastin e shpërndarjes së Kuvendit, mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë si dhe veprimet pasuese institucionale pas situatave të tilla, në drejtim të mbajtjes së procesit të ri zgjedhor apo mundësinë e dhënies së të drejtës së mandatarit për formim të një Qeverie të re brenda periudhës së përcaktuar kushtetuese 4-vjeçare sa është i vlefshëm mandati i Kuvendit.

23 Po aty, fq. 2 dhe 3

24 Lexo dhe analizo formulimin e neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

25 Lexo mendimin mospajtues të dy gjyqtarëve në rastin KO 29/11, faqe 4

26 Aktgjykimi KO 72/20 – “Objekti i çështjes”

Është e rëndësishme të kuptohet se nevoja për ofrimin e opinionit të tillë nga Gjykata Kushtetuese ka ardhur në konsekuencë të një gjendje të votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë më 25 mars të vitit 2020, që ndër të tjera ishte edhe situatë e pandemisë globale. Megjithatë, pas këtij vendimi nga më shumë se 2/3 e Kuvendit, subjekti që udhëhiqte me Qeverinë insistonte në zgjedhjet e reja parlamentare duke u thirrur në nenin 82.2 të Kushtetutës, ndërkaq shumica absolute e partive politike që kishin votuar mocionin e mosbesimit kishin shprehur vullnetin për vazhdim të mandatit të asaj përbërje të Kuvendit si dhe formimin e një Qeverie të re.

Presidenti i vendit, i mveshur me rolin e kryerjes dhe harmonizimit të detyrave për caktimin e mandatarit për formim të Qeverisë<sup>27</sup>, pas shkëmbimit serik të letrave publike dhe zyrtare me Kryetarin (atëbotë Kryeministër në detyrë) e subjektit “Lëvizja VETËVENDOSJE” që kishte dalur forca e parë në zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019, kishte konsideruar se ai po e refuzon të drejtën për propozimin e emrit për mandatar të formimit të Qeverisë së re dhe me 30 prill, pas konsultimeve me partitë e tjera, kishte nxjerrë Dekret presidencial përmes të cilit kishte caktuar mandatar për Kryeministër një nga deputetët e subjektit politik që kishte rezultuar si forca e dytë politike në zgjedhje.

Gjykata, në vlerësimin pozitiv - në përputhje me Kushtetutën të Dekretit të Presidentit, kishte theksuar se funksionimi demokratik i institucioneve është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizime publike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për Republikën e Kosovës, ashtu që kjo e fundit të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar dhe aspiratave të mishëruara<sup>28</sup>.

Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese është përkujdesur që rëndësi të veçantë t’i kushtojë faktit të pengimit të mundësisë për bllokim institucional të organeve qoftë legjislative apo ekzekutive, duke i vlerësuar indikacionet përmes shprehjes së vullnetit nga veprimet e përfaqësuesve politikë dhe institucionale përkritazi me detyrimet që bartin falë pozicionit të tyre të derivuar nga mbështetja popullore.

Përfundimisht, përmes këtij Aktgjykimi që unanimisht e kishte vlerësuar kushtetues Dekretin e Presidentit të datës 30 prill 2020, Gjykata Kushtetuese i kishte hapur rrugë formimit të Qeverisë së re pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, kështu duke i dhënë epilog një nga rasteve më interesante institucionale dhe politike të vendit si dhe njëkohësisht duke gdhendur kronologjinë e veprimeve procedurale në elaborim të situatave të tilla.

### III. Përfundim

Siç është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në disa raste që kanë përfshirë fushëveprimin kushtetues të Presidentit si kreu i shtetit, roli i Presidentit në arbitrimin e jetës kushtetuese në Rep. e Kosovës duhet parë brenda kufijve së filozofisë së pushtetit neutral, koncept ky që ankorohet në natyrën kushtetuese të Presidentit në sisteme parlamentare. Përmes vendimeve kushtetuese interpretative, Gjykata Kushtetuese e Kosovës është kujdesur që të dekonstruktoj më tej nocionin e “pushtetit neutral” në dritën e kompetencave kushtetuese presidenciale dhe ta bëj më të qartë për institucionet dhe publikun e gjerë se ushtrimi i këtyre kompetencave presidenciale është fundamental për arbitrimin dhe balancimin e jetës kushtetuese në Rep. e Kosovës.

27 Lexo kompetencën e 14-të të Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 84 i Kushtetutës së Kosovës

28 Paragrafi 580 i Aktgjykimit KO 72/20